



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2208/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI159/22

Parashtrues

Besarta Isufi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-22-0385] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 31 gushtit 2022

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Besarta Isufi, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës). Parashtruesja e kërkesës përfaqësohet nga Adem Vokshi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-22-0385] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së) të 31 gushtit 2022 në lidhje me Aktvendimin [C-III-22-0148] e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së) të 7 qershorit 2022.
3. Aktvendimi [AC-I-22-0385] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i 31 gushtit 2022, i është dorëzuar përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës më 2 shtator 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, “për ndalimin e ekzekutimit të Aktvendimit të DHPGJS-së [C-III-22-0148]”.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 18 tetor 2022, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [nr. GJR. KI159/22] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [nr. KSH. KI159/22] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha, anëtarë.
9. Më 31 tetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
10. Më 8 dhjetor 2022, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës të dorëzojë në Gjykatë Aktvendimin [C-III-22-0148] e DHPGJS-së të 15 korrikut 2022, në mënyrë që Gjykata të vazhdojë më tej me procedimin.

11. Më 14 dhjetor 2022, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës Aktvendimin e kërkuar [C-III-22-0148] të DHPGJS-së, të 15 korrikut 2022.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 10 janar 2023, Gjykata kërkoi informata shtesë nga DHPGJS-ja lidhur me kërkesën e parashtrueses.
14. Më 26 janar 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga DHPGJS-ja lidhur me kërkesën e Gjykatës.
15. Më 23 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Gjykata që në fillim të shqyrtimit të gjendjes faktike vëren se thelbi i procedurës para kolegjeve të DHPGJS-së ndërlidhet me vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi dy ngastrat kadastrale, nr. 1413 dhe nr. 1416, të regjistruara me nr. 0-71208072-01413-0-185-0, në Zonën Kadastrale të Mitrovicës, në sipërfaqe prej 239 m², mbi të cilat të dyja palët, përkatësisht Ndërmarrja Shoqërore “Jugobanka”, e cila përfaqësohet nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së (në tekstin e mëtejme: paditësi AKP) dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut, konsiderojnë se kanë të drejta. Duke pasur parasysh këtë, paditësi AKP, pranë gjykatave kompetente, inicioi tri kërkesëpadi, përkatësisht:
 - i) kërkesëpadinë kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat në fjalë;
 - ii) kërkesëpadinë kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut për shkak të pengimit të posedimit;
 - iii) propozimin për caktimin e masës së sigurimit.
17. Megjithatë, Gjykata, duke shqyrtuar me kujdes shkresat e lëndës, gjeti se në kërkesën e saj parashtruesja konteston shprehimisht procedurën gjyqësore të zhvilluar sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit mbi ngastrat kontestuese, andaj, në vazhdim të aktvendimit, Gjykata do t'i paraqesë faktet që janë të rëndësishme për të kuptuar thelbin e kërkesës në raport me procedurën e kontestuar gjyqësore.
18. Më 15 mars 2013, paditësi AKP e parashtrroi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë padinë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke pretenduar se ai është pronar i ngastrave nr. 1413 dhe 1416, të regjistruara në kadastër në emër të Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, duke kërkuar: *“... që të obligohet e paditura, respektivisht Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK të Mitrovicës që të kryen regjistrimin e të drejtës së pronësisë të pronës së paluajtshme të theksuar në pikën e parë ... në regjistër në dobi të paditësit Banka Themelore “Jugobanka” në Mitrovicë, si dhe të obligohet që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës...”*.
19. Më 29 prill 2021, Komuna e Mitrovicës së Jugut nxori vendimin që një pjesë e ngastrave në fjalë në sipërfaqe prej 139 m² të këmbëhet me një pjesë të ngastrës kadastrale të parashtrueses së kërkesës në sipërfaqe prej 102 m².
20. Duke pasur parasysh se është bërë këmbimi i një pjese të ngastrave që janë objekt i kontestit që është duke u zhvilluar lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë,

paditësi AKP inicioi një procedurë të re gjyqësore me propozimin për caktimin e masës së sigurimit mbi ngastrat në fjalë.

Procedura gjyqësore lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit

21. Më 28 mars 2022, paditësi AKP dorëzoi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë propozimin për caktimin e masës së sigurimit kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe kundër parashtrueses së kërkesës, duke marrë parasysh se është bërë këmbimi i një pjese të ngastrave në fjalë me një pjesë të ngastrës së parashtrueses së kërkesës.
22. Më 1 prill 2022, Gjykata Themelore në Mitrovicë përmes Aktvendimit [C. nr. 346/22] u shpall jokompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe i dërgoi shkresat e lëndës në DHPGJS.
23. Më 10 maj 2022, Gjykata Themelore në Mitrovicë përmes aktit përcjellës i dërgoi shkresat e lëndës në DHPGJS.
24. Më 3 qershor 2022, Komuna e Mitrovicës së Jugut e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen e saj ndaj kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, në të cilën theksoi se ajo kishte nxjerrë një aktvendim për këmbimin e pronës me parashtruesen e kërkesës [...], se ajo kundërshton propozimin për caktimin e masës së sigurimit sepse dhënia e një mase të tillë do të paragjykonte vendimet meritore në lidhje me dy paditë e ngritura dhe se AKP nuk ka paraqitur pretendime për ekzistimin e një të drejte subjektive mbi pronën në fjalë, dhe as prova për dëmet e menjëhershme dhe të pariparueshme. [...].
25. Më 6 qershor 2022, paditësi AKP iu përgjigj kërkesës së DHPGJS-së, duke dorëzuar, përveç propozimit për caktimin e masës së sigurimit, edhe padinë për pengimin e posedimit, lirimin e pronës dhe kompensimin e dëmit kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe parashtrueses së kërkesës.
26. Më 7 qershor 2022, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [C-III-22-0148] përmes të cilit (i) aprovoi si të bazuar kërkesën e AKP-së për caktimin e masës së sigurimit kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe parashtrueses së kërkesës për vazhdimin e punimeve në hapësirën afariste dhe tjetërsimin e pronës në të ardhmen; (ii) masa e sigurimit mbetet në fuqi deri në vendosjen e çështjes kontestimore sipas padisë së paditësit AKP për pengimin e posedimit të paraqitur më 6 qershor 2022.
27. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në Aktvendimin e tij [C-III-22-0148], ndër të tjera, theksoi se:

“Sipas Nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, gjykata mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit...”.

[...]

“Kjo gjykatë konsideron se, janë përmbushur kriteret e parapara me nenin 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, për arsyet si në vijim: Paditësja AKP-ja nga pretendimet e pohuara në padi (C. nr. 206/2013) dhe në kërkesën për masë të sigurimit si dhe me provat e dorëzuara në gjykatë, në këtë fazë të procedurës e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës subjektive të saj në pasurinë e

paluajtshme për të cilën kërkohet masa e sigurisë për arsye se nuk është kontestuese se Objekti i Bankës "Jugobanka" (më vonë Bankkos) është pronë shoqërore me të cilën qeverisë Agjencia Kosovare e Privatizimit e që nënkupton se çfarëdo ndryshimi lidhur me pronësinë e këtij objekti si send i paluajtshëm nuk mund të bëhen pa lejen dhe pëlqimin e AKP-së".

[...]

"Kjo gjykatë konsideron se plotësohet edhe kushti tjetër që kërkohet konform nenit 61 par. 1 të Ligjit Nr. 06/L-086 se në rast të mos caktimit të masës së sigurisë, propozuesja do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme sepse ekziston rreziku që kundër propozuesja e parë këtë pasuri të paluajtshme ta tjetërsoi te persona privat apo subjekte juridike me pronësi dhe kapital privat".

28. Më 29 qershor 2022, Komuna e Mitrovicës së Jugut paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktvendimit [C-III-22-0148] të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 7 qershorit 2022, duke ngritur të njëjtat argumente si në përgjigjen ndaj kërkesës për caktimin e masës së sigurimit.
29. Më 19 korrik 2022, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C-III-22-0148] të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 7 qershorit 2022, duke kërkuar që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet si i pabazuar propozimi për masën e sigurimit. Për më tepër, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës theksoi se vendimi i kontestuar nuk është i mbështetur ligjërish për arsye se nuk janë plotësuar kushtet për miratimin e masës së sigurimit në bazë të nenit 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme pasi që e njëjta nuk ka pasur mundësi t'iu përgjigjet me kohë deklarimeve të propozuesit për caktimin e masës së sigurimit.
30. Më 2 gusht 2022, paditësi AKP dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë me të cilën iu përgjigj përgjigjes së Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke e kundërshtuar ankesën në tërësi, për shkak se Komuna nuk ka paraqitur asnjë bazë të besueshme ligjore dhe as nuk ka vërtetuar ndonjë gjendje faktike të ndryshme nga ajo e vërtetuar me Aktvendimin e kontestuar. Për më tepër, paditësi AKP pretendoi se *"ka ofruar prova të mjaftueshme për të dëshmuar se prona e Ndërmarrjes Shoqërore është pronë shoqërore dhe se si e tillë nuk mund të këmbehet me persona privat"*.
31. Më 4 gusht 2022, paditësi AKP, përsëri e dorëzoi në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së një parashtrësë në formë të përgjigjes ndaj ankesës së paraqitur nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, duke pretenduar se ajo nuk ishte e bazuar në ligj. Në këtë parashtrësë, paditësi AKP, theksoi se parashtruesja e kërkesës nuk e arsyetoi pretendimin se gjykata kishte shkelur procedurën kontestimore, dhe as pretendimin për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
32. Më 31 gusht 2022, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nxori Aktvendimin [AC-I-22-0385], përmes të cilit refuzoi ankesat e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe parashtrueses së kërkesës, duke vërtetuar Aktvendimin e shkallës së parë të DHPGJS-së [C-III-22-0148] të 7 qershorit 2022.
33. Në arsyetimin e tij, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së theksoi se:

[...]

"Në lëndën në fjalë, Kolegji i Apelit vëren se paditësi me Propozimin për caktimin e masës së sigurisë të dorëzuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me datë 28 mars 2022, dhe me padinë e dorëzuar në DHPGJS më 08 qershor 2022, ka dorëzuar disa prova bindëse për gjykatën se ajo e ka të drejtën e pronësisë për

objektin e Bankës Themelore “Jugobanka” në Mitrovicë, e cila me Leje të Komunës së Mitrovicës ishte ndërtuar në ngastrat nr. 01413/0 dhe 1416/0, të cilat ngastra në bazë të regjistrit kadastral janë në pronësi të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se e paditura e I-rë ka marrë Vendim nr. 02-060/01-0029209/21-7 të datës 29.04.2021, me të cilin ajo ka vendosur që një pjesë të sipërfaqes prej 139 m² të pronës lëndore, ta këmbëj me një pjesë të pronës së personit privat në sipërfaqe prej 102 m². Andaj edhe ky veprim i Komunës së Mitrovicës së Jugut i ndërmarrë pa lejen e AKP-së, paraqet veprim që nuk është në përputhje me Ligjin e AKP-së, dhe ky veprim ka rrezik që të shkakton tjetërsimin e pronës lëndore nga personat privat. Po ashtu nëse vazhdojnë punimet e filluara në objektin lëndor, mund të vjenë deri te ndryshimi i strukturës edhe të gjendjes fizike të objektit, për të cilin AKP-ja ka ofruar dëshmi se është pronë shoqërore e Bankës Themelore “Jugobanka” në Mitrovicë.

[...]

Të paditurat në ankesën e tyre pretendojnë se me Aktvendimin e ankimuar janë shkelur dispozitat procedurale dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Këto pretendime nuk janë argumentuar, andaj nuk konsiderohen pretendime të drejta, prandaj nuk i pranon si të bazuara Kolegji i Apelit.

[...] Kolegji i Apelit ankesën e [...] të paditurës së II-të e refuzon si të pabazuar dhe e vërteton Aktvendimin e Kolegjit të shkallës së parë, sa i përket meritave, si të drejtë dhe të bazuar në ligj”.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

34. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pretendon se aktvendimet e të dy kolegjeve të DHPGJS-së cenojnë të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
35. Në mbështetje të shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës shton se, “[...] nëse masa e sigurimit përcaktohet pa mbajtur seancë, ajo duhet të caktohet për një periudhë kohore të caktuar dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim”.
36. Më tej, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës thekson se, “Në bazë të nenit 61 par. 2 të ligjit për DHPGJS-së, Gjykata është dashur që paditurave Komunës së Mitrovicës dhe parashtrueses së kërkesës, t’ua jep mundësinë që t’i paraqesin argumentet kundërshtuese të tyre kundër propozimit për caktimin e masës së sigurisë. Mirëpo, Gjykata për arsye të panjohur vetëm të paditurës së parë ia ka dhënë mundësinë për t’i paraqitur argumentet kundërshtuese, duke ia dorëzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë dhe provat”. Në këtë kontekst, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pretendon se gjykata me këto veprime shkeli parimin e kontradiktoritetit, që është një hap i domosdoshëm procedural për t’ua mundësuar palëve një trajtim të barabartë dhe të kenë mundësi të kundërshtojnë pretendimet dhe argumentet e palës kundërshtare, dhe për rrjedhojë, mosdërgimi i padisë, propozimit dhe provave, si dhe mungesa e mundësisë për parashtruesen e kërkesës për t’u përgjigjur, përbëjnë shkelje të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

37. Sa i përket shkeljes së nenit 32 të Kushtetutës, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pretendon se i tërë procesi gjyqësor ishte i padrejtë dhe ishte zhvilluar në kundërshtim me Kushtetutën, për arsye se asaj nuk i është mundësuar paraqitja e provave. Më konkretisht, gjykata e shkallës së dytë nuk e mori në shqyrtim pretendimin e saj ankimor se provat e saj nuk janë shqyrtuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa pikërisht ky pretendim ka qenë vendimtar për të marrë një vendim të ligjshëm. Rrjedhimisht, ai konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka mundur t'i përdorë mjetet juridike në procedurë në mënyrë efektive.
38. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, ndër të tjera, ngre pretendimin që i referohet pjesës e procedurës e cila është ende në fazën e shqyrtimit dhe vendosjes nga kolegjet kompetente të DHPGJS-së, dhe ndërlidhet me padinë për pengim të posedimit. Më konkretisht, lidhur me këtë, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës konsideron se *“është dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor prej 30 ditësh të paraparë me nenin 114 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, dhe se pas skadimit të afatit ligjor prej 30 ditësh shuhet e drejta për të kërkuar mbrojtje nga ana e gjykatës për pengim posedim”*.

Pretendimet lidhur me caktimin e masës së përkohshme

39. Sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës thekson se përmes ndalimit të vazhdimtë të punimeve në hapësirën afariste dhe ndalimit të tjetërsimit të pronës, parashtrueses së kërkesës i shkaktohet dëm tejet i madh dhe i pariparueshëm pasi që i pamundësohet shfrytëzimi i objektit për një periudhë të pacaktuar kohore. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pretendon se: *“... është dëm i vazhdueshëm pasi që të njëjtës i pamundësohet shfrytëzimi i objektit përfshirë edhe inkasimi i qirasë në vlerë prej 2,500.00 € në muaj apo në shumë prej 3,000.00 € në vit. Kur kihet parasysh se ky proces gjyqësor mund të zgjasë me vite të tëra (njëra padi e paraqitur nga AKP është e vitit 2013 ndërsa tjetra është paraqitur në vitin 2022) rrjedh se ky dëm [...] mund të arrijë në shumë tejet të lartë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes”*. Gjithashtu, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës thekson se Ligji për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullorja e punës përcaktojnë dy baza jokumulative: (i) për të evituar rreziqet ose dëmet e pariparueshme dhe (ii) se marrja e këtyre masave të përkohshme është në interesin publik, dhe për të cilat në rastin konkret pretendohet se të dyja janë përmbushur.
40. Në fund, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme dhe të ndalojë ekzekutimin e Aktvendimit [C-III-22-0148] të DHPGJS-së, si dhe të deklarojë kërkesën të pranueshme, duke konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe njëkohësisht të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [AC-I-22-00385] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 31 gushtit 2022 dhe Aktvendimin [C-III-22-0148] e DHPGJS-së të 7 qershorit 2022. Përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës propozon që Aktvendimi [C-III-22-0148] i DHPGJS-së i 7 qershorit 2022 t'i kthehet DHPGJS-së në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatare, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1

(E drejta për një proces të rregullt)

1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

[...]

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 61

Masat e sigurimit

1. “Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë/ padie.
2. Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim. Kur ekzistojnë rrethana urgjente që detyrojnë Dhomën e Posaçme të

veprojë menjëherë lidhur me propozimin, atëherë Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim për propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa ia dorëzuar propozimin palës tjetër. Masa e sigurimit caktohet vetëm për një periudhë kohore të caktuar dhe mund të zgjatet pas parashtrimit të kërkesës”.

[...]

Neni 6 Paditësit dhe të paditurit

[...]

2. *“I paditur në procedurat para Dhomës së Posaçme është::*

2.5. *[...] secili person të cilin Dhoma e Posaçme apo ndonjë kolegj i saj e konsideron të domosdoshëm apo të përshtatshëm për ta pranuar si Palë Kundërshtare me qëllim të sigurimit të gjykimit të plotë dhe të saktë të rastit apo çështjes në fjalë.”*

[...]

LIGJI NR. 03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

Neni 114 Shuarja e kërkesës

“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

41. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

43. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

44. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-22-0385] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 31 gushtit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
45. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, që përcakton se:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
46. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
47. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ1-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së,

Kemmachev kundër Francës, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), Mentzen kundër Letonisë, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe Trofimchuk kundër Ukrainës, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).

48. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës ndërlidhet me procedurën e iniciuar nga paditësi AKP përmes propozimit për caktimin e masës së sigurimit. Gjykata rikujton se fillimisht Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, e më pas Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, caktuan masën e sigurimit mbi ngastrat në fjalë, deri në marrjen e vendimit për të drejtat pronësore në procedurën kryesore e cila është duke u zhvilluar pranë kolegjeve të DHPGJS-së.
50. Pikërisht ky fakt do të jetë udhërrëfyes për Gjykatën gjatë trajtimit të kërkesës së parashtrueses. Gjithashtu, Gjykata duhet të theksojë se këtë kërkesë do ta shqyrtojë vetëm në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës, duke mos u lëshuar në ato pretendime që ndërlidhen drejtpërdrejt me procedurat e tjera gjyqësore që janë në procesin e vendimmarrjes.
51. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës bazën e shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, lidhur me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, e ndërlidh me pretendimet se: **i)** nuk janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit të përcaktuara në nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, **ii)** masa e sigurimit ka mundur të caktohet vetëm pasi të gjitha palët të kishin paraqitur argumentet e tyre dhe se masa nuk ka qenë urgjente, **iii)** masa e sigurimit është caktuar pa mbajtur seancën publike, **iv)** masa e sigurimit është dashur të përcaktohet me kohëzgjatje.
52. Megjithatë, para procedurës së analizimit të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës i ndërlidh si me procedurën e vendimmarrjes në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, ashtu edhe në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, gjë që në thelb i imponon Gjykatës detyrimin që të dy vendimet “t’i shqyrtojë në tërësinë e tyre” në kontekst të shkeljeve të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, gjë që është në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), e cila thotë se “është detyrë e Gjykatës që të shqyrtojë procedurat në tërësi, që në rastin konkret përfshin të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta në një procedurë të vetme” (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Helmers kundër Suedisë, të 29 tetorit 1991, kërkesa nr. 11826/85, Seria A nr. 212, faqe 15, paragrafi 31).
- i) në lidhje me pretendimin për mosplotësimin e kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurisë**
53. Gjykata, duke iu kthyer rastit konkret dhe duke shqyrtuar pretendimin e parë dhe të dytë të parashtrueses së kërkesës, përkatësisht pretendimet se shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ka ndodhur për arsye se **i)** nuk janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit, të përcaktuara

në nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata rikujton se neni 61 paragrafi 2 i Ligjit të përmendur (të cituar më lart), parashikon kushtet që duhet të plotësojë një propozim për vendosjen e masës së sigurisë në mënyrë që të jetë i pranueshëm.

54. Prandaj, Gjykata rikujton se dispozita ligjore e lartpërmendur në përmbajtjen e saj parashikon dy kushte që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe ato janë i) “ekzistenca e së drejtës subjektive” dhe ii) “ekzistenca e “rrezikut nga dëmi i pariparueshëm”, në mënyrë që propozimi për vendosjen e masës së sigurisë të jetë i bazuar. Në mbështetje të kësaj, gjykatat e rregullta janë të obliguara të vlerësojnë nëse propozimi i paraqitur i plotëson kushtet e përcaktuara të dispozitës së lartpërmendur ligjore.
55. Në të vërtetë, Gjykata, duke shqyrtuar arsyetimin e vendimeve të të dy kolegjeve të dhomës së posaçme, vëren se para miratimit të propozimit për vendosjen e masës së sigurisë të paraqitur nga paditësi AKP, ato vlerësuan përmbushjen e kushteve të lartpërmendura. Në bazë të provave të paraqitura së bashku me propozim, dhe se vetëm pas vlerësimit të tyre konstatuan se janë plotësuar të dyja kushtet, gjë që çoi në miratimin e propozimit.
56. Gjykata në këtë pikë duhet të theksojë se ajo nuk do të lëshohet në analizën dhe vlerësimin e cilësisë së propozimit për caktimin e masës së sigurimit të paraqitur nga paditësi AKP, prandaj as nuk do të shprehë mendimin e saj për çështjen nëse thelbi dhe përmbajtja e propozimit të paditësit AKP i plotësojnë kushtet që mund të kualifikohen si “*rrethana urgjente*” sepse kjo çështje është ekskluzivisht në juridiksionin e gjykatave të rregullta, në këtë rast në juridiksionin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së. Një qëndrim i tillë i Gjykatës rezulton nga fakti se është pikërisht roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë gjendjen faktike dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, rastin [Akdivar kundër Turqisë](#), nr. 21893/93, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; rastin [Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35394/97, GJEDNJ, Aktgjykim i 4 tetorit 2000, paragrafi 34; shih, po ashtu, rastin [KI70/11](#), parashtrues: [Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima](#), Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).
57. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses së kërkesës se propozimi për vendosjen e masës së sigurisë nuk plotëson kushtet e nenit 61 të ligjit të përmendur, janë të pabazuara.
- ii) Në lidhje me pretendimin se masa e sigurisë mund të vendosej vetëm pasi të gjitha palët të kenë paraqitur argumentet e tyre dhe se masa nuk ishte urgjente*
58. Në mbështetje të pretendimit të dytë të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se dispozita e përmendur e paragrafit 2 të nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në pjesën e saj të dytë thotë, “*kur ekzistojnë rrethana urgjente [...] atëherë Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim për propozimin për caktimin e masës së sigurimit pa ia dorëzuar propozimin palës tjetër*”.
59. Është evidente se paragrafi 2 i nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086, parasheh edhe përjashtime të caktuara kur masa se sigurimit mund të vendoset pa deklarimin paraprak të palës kundërshtare, me kusht që propozimi i plotëson kushtet e “*rrethanave urgjente*”. Në bazë të kësaj është e qartë se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nuk e interpretoi në mënyrë restriktive dispozitën e lartpërmendur kur nxori vendimin për caktimin e masës së sigurimit pa i dhënë mundësinë palës kundërshtare për t’iu përgjigjur asaj.

60. Me qëllim që Gjykata të sqarojë edhe më tepër veprimet e Dhomës së Posaçme të DHPGJS-së, ajo i kthehet sërish pjesës së paragrafit 2 të nenit 61 të ligjit të përmendur, ku thuhet “*kur ekzistojnë rrethana urgjente*”, ku Gjykata, gjatë shqyrtimit të pjesës përkatëse të paragrafit 2, gjen se vetë ligji e kualifikon veprimin procedural në fjalë, përkatësisht propozimin për caktimin e masës së sigurimit, si “*rrethanë urgjente*”, gjë që në vetvete kërkon vendimmarrje të përshtetshme sipas një propozimi të tillë.
61. Gjykata konstaton se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke vlerësuar rrethanat në të cilat kërkohet vendosja e masës së sigurisë për rastin, konkludoi se ato rrethana plotësojnë kriterin e urgjencës, duke vendosur kështu rastin, për të cilën kërkohet vendosja e masës së sigurisë, në sistemin e mbrojtjes institucionale.
62. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të procedurës pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, në mbështetje të pretendimit se parashtruesja e kërkesës nuk ka pasur mundësi të deklarohet në lidhje me propozimin e paditësit AKP, për këtë Gjykatë nuk është kontestues fakti nëse parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi për të kundërshtuar propozimin e propozuesit, sepse nga shkresat e lëndës, përmbajtja e kërkesës së saj, si dhe nga vetë vendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, mund të konkludohet se ajo si kundërpropozuese ka pasur mundësi që përmes përfaqësuesit të saj pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të deklarohet dhe t'i përgjigjet me shkrim propozimit të paditësit AKP. Më konkretisht, Gjykata gjen se përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës, më 19 korrik 2022, paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C-III-22-0148], duke kërkuar që Aktvendimi i ankimuar të ndryshohet dhe të refuzohet si i pabazuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit, duke paraqitur argumente me të cilat e kundërshtoi propozimin e paditësit AKP.
63. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i shqyrtoi argumentet e paraqitura të parashtrueses së kërkesës, me të cilat ajo kundërshtoi propozimin e paditësit AKP, ku ajo në radhë të parë theksoi “*shkeljen e dispozitave procedurale dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale*”. Pikërisht siç rezulton nga Aktvendimi i kontestuar, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke i shqyrtuar këto pretendime në kontekst të shkeljeve të mundshme, vlerësoi se “*këto pretendime nuk janë argumentuar, andaj nuk konsiderohen pretendime të drejta, prandaj nuk i pranon si të bazuara Kolegji i Apelit*”.
64. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata konsideron se të dy kolegjet e Dhomës së Posaçme, në përputhje me specifikat e tyre, në kuptimin procedural, kanë respektuar parakushtet ligjore të parashikuara me nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit të lartpërmendur, në mënyrën e parashikuar në të. Rrjedhimisht, Gjykata i konsideron të pabazuara të dyja këto pretendime të parashtrueses së kërkesës.

iii) në lidhje me pretendimin se masa e sigurisë është vendosur pa mbajtjen e seancës publike

65. Më tej, sa i përket pretendimit të tretë të parashtrueses së kërkesës, **iii)** se masa e sigurimit është caktuar pa mbajtur seancën publike, Gjykata konsideron se ajo, duke iu përgjigjur pretendimit të parë dhe të dytë të parashtrueses së kërkesës, iu përgjigj gjithashtu edhe pretendimit të tretë të saj. Megjithatë, Gjykata do ta përsërisë edhe në këtë pjesë, në mënyrë që të jetë më e kuptueshme dhe më e qartë për parashtruesen e kërkesës. Në mbështetje të kësaj, Gjykata i kthehet sërish përmbajtjes së dispozitës ligjore të nenit 61 paragrafi 2 të Ligjit të lartpërmendur, ku thuhet se gjykata mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit “[...] *pa mbajtjen e seancës dëgjimore*”. Në mbështetje të kësaj, Gjykata konstaton se dispozita

ligjore e cekur më lart nuk përmend shprehimisht një seancë publike gojore, por me shkrim, të cilën parashtruesja e kërkesës, sipas konkluzioneve të Gjykatës, e ka pasur në kuptimin procedural në një pjesë të procedurës gjyqësore.

66. Rrjedhimisht, Gjykata e konsideron të pabazuar pretendimin e parashtrueses së kërkesës se shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ka ndodhur për shkak të mosmbajtjes së seancës publike gjatë procedurës së vendosjes për propozimin për caktimin e masës së sigurimit.

iv) në lidhje me pretendimin se është dashur të përcaktohet kohëzgjatja e masës së sigurisë

67. Sa i përket pretendimit të katërt, **iv)** se masa e sigurimit është dashur të përcaktohet me kohëzgjatje, Gjykata thekson se propozimi nga padia për caktimin e masës së sigurimit realizohet në procedura të posaçme, që janë të ndara nga procedura e kërkesëpadisë në merita, dhe këto procedura, siç e kemi parë nga pjesa e cituar të paragrafit 2 të nenit 61 të Ligjit të lartpërmendur, në parim janë procedura të shpejta. Në këto procedura vendoset përkohësisht për marrjen e një ose disa masave me karakter të përkohshëm, por që mund të zgjasin deri në realizimin faktik të kërkesës kryesore të propozuesit të sigurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e vendimit për sigurimin nuk është e kufizuar me kohë, por mund të zgjasë deri në marrjen e vendimit në merita, ose kur gjykata e cila ka caktuar masën e sigurimit vlerëson se janë mënjtuar të gjitha kushtet dhe supozimet për të cilat ajo është caktuar dhe për këtë arsye është e panevojshme që ajo si e tillë të vazhdojë të jetë në fuqi.
68. Prandaj, duke e shqyrtuar me kujdes pretendimin konkret të parashtrueses së kërkesës me përmbajtjen e vendimeve të të dy kolegjeve të Dhomës së Posaçme lidhur me kohëzgjatjen e masës së sigurimit, Gjykata gjen se të dy kolegjet e Dhomës së Posaçme kanë përcaktuar shprehimisht kohëzgjatjen e saj, në atë mënyrë që intervalin e saj të kohëzgjatjes e ndërlihdën me kohën e përfundimit të procedurës mbi meritat e kërkesëpadisë së propozuesit, përkatësisht, siç thuhet në Aktvendim, se *“Kjo masë e sigurisë mbetet në fuqi deri në vendosjen e çështjes kontestimore sipas Padisë së AKP-së”* (pika II e Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së).
69. Një qëndrim të tillë të dy kolegjeve të Dhomës së Posaçme, Gjykata e konsideron të justifikuar për arsye se nga momenti i inicimit të kërkesëpadisë në merita deri në realizimin faktik të së drejtës subjektive, përkatësisht deri në marrjen e vendimit në merita, madje edhe zbatimin e tij, mund të kalojë një kohë e konsiderueshme, dhe kjo në vetvete justifikon qëndrimin e të dy kolegjeve të Dhomës së Posaçme në rastin konkret.
70. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata edhe këtë pretendim të parashtrueses së kërkesës, në të cilin konsideron se shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ka ndodhur për shkak se gjykatat nuk kanë përcaktuar afatin kohor të kohëzgjatjes së masës së sigurimit, e vlerëson të pabazuar.

Pretendimet e tjera

71. Më tej, sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, pavarësisht nga fakti se parashtruesja e ka përmendur në kërkesë si shkelje të mundshme, Gjykata konsideron se nuk ka arsye të bazuara për t'i trajtuar më tej këto pretendime, për arsye se është e qartë se parashtruesja e kërkesës gjatë procedurës sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, siç është theksuar nga Gjykata në pjesën e mëparshme të aktvendimit, ka pasur në dispozicion dhe ka ushtruar mjete juridike në formën dhe mënyrën e parashikuar me nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-086 për

Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Prandaj, Gjykata vlerëson se edhe këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë të pabazuara.

72. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton se në kërkesën e saj para Gjykatës, parashtruesja e kërkesës ka ngritur edhe pretendime që nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me procedurën e cila është analizuar nga Gjykata në pjesën e mëparshme të aktvendimit. Këto pretendime i referohen procedurës lidhur me padinë për pengim posedimi, ku parashtruesja e kërkesës ngre pretendime për parashkrimin e mundshëm të kësaj kërkesëpadie, në bazë të nenit 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore. Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se në këtë kërkesë, ajo nuk është e thirrur të paraqesë mendimin e saj për një procedurë që nuk është objekt i kësaj kërkesë dhe për këtë arsye në vijim nuk do të merret me të.
73. Si përfundim, Gjykata duke konstatuar se pretendimet mbi të cilat parashtruesja e kërkesës bazoi shkeljet e pretenduara të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, rezulton se në procedurën e caktimit të masës së përkohshme nuk ka pasur shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

74. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe pretendimet për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, janë pretendime që kualifikohen si (iii) pretendime *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*. Prandaj, kërkesa në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

75. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme me qëllim të evitimit të ekzekutimit të Aktvendimit [C-III-22-0148] të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për arsye se *“përmes ndalimit të vazhdimit të punimeve në hapësirën afariste dhe ndalimit të tjetërsimit të pronës në të ardhmen, parashtrueses së kërkesës i shkakton dëm tejet i madh dhe i pariparueshëm pasi që i pamundësohet shfrytëzimi i objektit për një periudhë të pacaktuar kohore [...]”*.
76. Megjithatë, Gjykata tanimë konkludoi se kërkesa e parashtrueses duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.
77. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në përputhje me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtrueses për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit, pasi që kërkesa është deklaruar e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27.1 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (d) dhe (2) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2023, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani